



KËSHILLI I LARTË GJYQËSOR

VENDIM

Nr. 27, datë 14.02.2019

PËR REFUZIMIN E KANDIDIMIT NË SKEMËN E DELEGIMIT

Këshilli i Lartë Gjyqësor, bazuar në nenet 4/3, 147/1, 147/a, pika 1, germa “a” të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, nenet 2 dhe 89 të ligjit nr. 115/2016, “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”, nenin 45 të ligjit nr.96/2016, “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, neni 4, germa “e”, neni 9, pika 1 e Rregullores “Për kriteret dhe procedurën e funksionimit të skemës së delegimit të gjyqtarit”, me propozim të Komisionit për Zhvillimin e Karrierës,

VENDOSI:

1. Refuzimin e kërkesës për kandidim në skemën e delegimit të {...} gjyqtar në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor {...}, për shkak se është i caktuar në mënyrë të përhershme në një gjykatë ku komandimi cenon funksionalitetin e tij.
2. Ky vendim hyn në fuqi në datën e botimit në faqen zyrtare të Këshillit të Lartë Gjyqësor.
3. Një kopje e vendimit t’i njoftohet gjyqtarit në adresën e vendit të punës, Gjykata e Rrethit Gjyqësor {...}.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

PËR KËSHILLIN E LARTË GJYQËSOR